

KONTRATE, ne mes te:

Data: 27.07.2020

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"EKO-ING" Sh.p.k-Prizren (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Furnizimi dhe montimi i kabllave elektrike në Shtëpin e Kulturës në Dragash me numër Identifikues **621-20-3168-1-3-6**, dhe nr, te mbrendshem **621-2020-071-136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi dhe montimi i kabllave elektrike në Shtëpin e Kulturës në Dragash**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **29.07.2020** dhe përfundon me **19.08.2020**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **2 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [ekzekutimit të punëve] do të jetë : **Shtëpia e Kultures ne Dragash.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
03 Nr. Br. 400-9104
27.07 20 20
Dragash - Dragash



Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,896.50€;**

(Nje mij e teteqind e nentedhjet e gjashte Euro e pesedhjet cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës , me raport nga ana e menaxherit të projektit dhe pranimin e punëve nga ana e komisionit të pranimit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim



8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Menagjer i kontrates nga AK është: Lirim Hajredini

Menagjer i projektit nga AK është: Nexhat Tershnjaku

Menagjer i projektit nga OE është: Xhelal Kukaj

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërpërja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore



13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Sërbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik			Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	“EKO-ING”	Sh.p.k-	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	menagjer		Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:			Nënshkrimi:	
Data:	27.07.2020.		Data:	27.07.2020.
Vula:			Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Eko Hyg - Shitësinja
e Kulturës

Nr.	FURNIZIMI DHE MONTIMI I KABLOVE ELEKTRIKE				
	Pershkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Çmimi	Çmimi Total
1	Demolimi vijor i kubëzave ekzistues si dhe parapregaditja e teren për hapjen kanalit për instalimet nëntoksore . Në çmim kalkulohet edhe kthihim i gjendjes ekzistues duke përfshirë edhe montimi i kubëzave pas përfundimit të punimeve. Në çmim llogaritet shenjat sinjalizimit të kablove tamponi t=15 cm dhe rëra t=5cm para se të rivendosen kubëzat.Llog. në m'	m'	10	30.00 €	300.0
2	Hapja e kanaleve me dimensione (60x80)cm për kabla furnizuese të objektit Kultures. Kanalet duhet të shtrihen sipas pozitës të dhënë në situacion..Llog. në m'	m'	10	30.00 €	300.0
3	Shtrirja e reres me trashësi 20cm në kanalet e mesiperme. Shtrirja kryhet në harmoni me rregullat teknike dhe në bazë të detalit të dhënë për këtë kanal.Llog. në m3	m³	1.6	30.00 €	48.0
4	Shkyqja, dhe dislokimi i kabllor ekzistues furnizues nga shtylla betonit të cilën e furnizon objektin e shtëpisë kulturore nga rrjeti i qytetit. Në çmim të llogaritet sigurimi i kabllor me kanale metalike në gjatësinë e shyllës nga beton armehja dhe përmes mbrojtës toksore kalimi dhe kyqja në objekt, Vërejtje përshihen të gjitha shpenzimet deri në funksion të plotë të objektit , duke përfshirë edhe atestet. .Llog. në m'	m'	20	10.00 €	200.0
5	Hegja e dheut të tepert dhe dërgimi në deponinë e qytetit apo ndonjë vend tjetër që e cakton kontraktuesi.	m³	4.8	5.00 €	24.0
6	Thyerja e betonit në hyrje të objekteve për depërtimin e kabllave deri te tabelat hyrse të objekteve. Pas vendosjes së kabllave duhet të mbyllën vend depërtimet me beton.	komplet	1	150.00 €	150.0
7	Blerja, shtrirja në kanale, përgatitja dhe lidhja e kabllave NYN 4x160mm²	m	150	3.20 €	480.0

✓

✓

✓

✓

✓

✓

✓

8	Shtrirja e shiritit detektues (me material magnetik) me gjersi 20cm ne te cilin duhet te shkruaj "Kujdes nga tensioni i lartë". Shiriti vendoset 20cm pa perfunduar mbushja.	m	150	0.10 €	15.0
9	Vendosja e mbrojtësve nga plastika per kablla te shtrira ne kanal. Mbrojtësi ka gjersi 40cm, form te shkronjes "V" te shtrirë dhe vendoset mbi shtresë te reres.	m	150	0.10 €	15.0
10	Shiriti Fe/Zn 25x4mm	kg	35	1.50 €	52.5
11	Kutia per pika shqyrtuese e paraparë për vendosje në tokë	copë	4	1.00 €	4.0
12	Pranues te rrufese te punuara nga shiriti Fe/Zn 25x4mm - 0.5m	copë	4	1.00 €	4.0
13	Lidhëse (vazhduese) standarde të	copë	4	1.00 €	4.0
14	Matjet , Atestet si dhe Punimi i dokumentacionit teknik me të gjitha ndryshimet e bera gjatë punes ,deklara e garancionit	paushall	1	300.00 €	300.0
ÇMIMI TOTAL:					1,896.50 €

OE: "EKO ING sh.p.k.
Nënshkrimi: _____

